



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. _____/2024

PËR

PËRGJEGJËSITË E ZGJERUARA TË SUBJEKTEVE PRODHUESE
TË PRODUKTEVE QË GJENEROJNË MBETJE¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të krijojë sistemin e përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese për produktet që gjenerojnë mbetje (në vijim, PZP) dhe të sigurojë që çdo person fizik ose juridik, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit në funksion të rritjes së ripërdorimit, parandalimit, riciklimit dhe rikuperimeve të këtyre produkteve.

Neni 2
Objekti i ligjit

1. Ky ligj ka si objekt përcaktimin e:

- a) masave të nevojshme, që ndërmerren nga subjekti prodhues, për të mbajtur përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit;
- b) rregullave për krijimin e funksionimit të sistemit të përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese për produktet që gjenerojnë mbetje dhe

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.312, datë 22.11.2008, faqe 3 - 30.

- të shoqërisë për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese (në vijim, SHPZP);
- c) rregullave për krijimin e mirëmbajtjen e regjistrit të prodhuesve PZP dhe SHPZP, që zbatojnë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Mbetje bashkiake”** janë:

- a) mbetje shtëpiake të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, pajisjet elektrike dhe elektronike, përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të tyre individuale apo të bashkuara dhe materialet e konsumit, që janë pjesë përbërëse e këtyre pajisjeve, mbetjet e baterive, mbetjet e vëllimshme, duke përfshirë mobiliet, dyshekët dhe të ngjashme;
- b) mbetje të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar nga burime të tjera, kur këto mbetje kanë natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake.

Mbetjet bashkiake nuk përfshijnë mbetjet nga prodhimi, bujqësia, pyjet, peshkimi, gropat septike, rrjetin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, sistemin e kullimit, si dhe llumrat e ujërave të ndotura, automjetet në fund të jetës, mbetjet nga ndërtimi.

- 2. **“Përdorues i fundit”**, çdo person fizik ose juridik, që përdor produktin për konsum final.
- 3. **“Subjekt prodhues”**, çdo person fizik apo juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit.
- 4. **“Subjekt prodhues i kontraktuar”**, prodhuesi i produkteve, pjesë e sistemit PZP, detyrimet e të cilit për PZP-në janë marrë përsipër nga SHPZP-ja.
- 5. **“Produkt PZP”**, produkti, pjesë e sistemit PZP.
- 6. **“Rryma specifike e mbetjeve”**, të gjitha rrymat e mbetjeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- 7. **“Sistemi i PZP-së”**, tërësia e rregullave, që kanë qëllim të sigurojnë që subjekti prodhues, i cili hedh në treg produkte, pjesë e regjimit të rrymave specifike të mbetjeve, të mbajë përgjegjësi financiare dhe organizative për të menaxhuar stadin e mbetjeve në ciklin e jetës së produktit.

8. **“Shoqëri për përgjegjësinë e zgjeruar të subjektit prodhues”** (në vijim, SHPZP), personi juridik i organizuar në formën e shoqërisë tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.
9. **“Vendosje në treg”**, furnizimi ose vënia në dispozicion për qarkullim për herë të parë në tregun shqiptar të produktit, pjesë e sistemit të PZP-së.

Neni 4 **Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet:

1. për të gjitha subjektet prodhuese, që zhvillojnë në Republikën e Shqipërisë aktivitete ekonomike, të cilat lidhen me qëllimin e ligjit, nën sistemin e PZP-së dhe hedhin për herë të parë në treg produkte, përdorimi i të cilave krijon mbetje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rrymat specifike të mbetjeve.
2. për rrymat specifike të mbetjeve të parashikuara, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si më poshtë vijon:
 - a) Ambalazhet e mbetjet e tyre;
 - b) Bateritë dhe akumulatorët;
 - c) Automjetet në fund të jetës;
 - ç) Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.
3. për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përmbushje të funksioneve të tyre, me qëllim arritjen e objektivave kombëtarë në fushën e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe atë për vetëqeverisjen vendore.

KREU II **SISTEMI I PËRGJEGJËSIVE TË ZGJERUARA TË SUBJEKTEVE** **PRODHUESE**

Neni 5 **Detyrimet e subjekteve prodhuese**

1. Çdo subjekt prodhues, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit përfshihet në sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese.
2. Subjekti prodhues ka këto detyrime:
 - a) Regjistrohet si subjekt i PZP-së në regjistrin përkatës, që administron Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

- b) Krijon dhe mban regjistrin për sasi të produkteve të prodhuara ose të importuara, të vendosura në treg;
 - c) Raporton për produktet e vendosura në treg në sasi dhe peshë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - ç) Pranon pa pagesë produktet e kthyera dhe mbetjet e krijuara pas përdorimit të tyre;
 - d) Menaxhon mbetjet e produkteve të parashikuara në shkronjën “b”, të kësaj pike, dhe merr/mbart përgjegjësi financiare për këto veprimtari;
 - dh) Zbaton detyrimet e sistemit PZP, veçanërisht lidhur me pagesën e kontributeve financiare dhe mbledhjen e të dhënave për produktet e vendosura në treg, nëse vendosja e sistemit PZP parashikohet në përputhje me nenin 6, të këtij ligji;
 - e) Informon konsumatorët për mënyrën e ripërdorimit, dorëzimit, sistemet e ngritura, vendet më të afërta, ndikimet, në përputhje me parashikimet e nenit 7, të këtij ligji, dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve.
3. Subjekti prodhues paraqet çdo vit një vetëdeklarim për vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve për vitin paraardhës pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, së bashku me bilancin vjetor. Vetëdeklarimi përmban, ndër të tjera, dhe të dhënat për sasi të kthyera të mbetjeve dhe për çdo lloj e kategori të tyre, për një vit të caktuar, si dhe të dhënat për dorëzimin e tyre ricikluesve ose trajtuesve të licencuar, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
 4. Subjekti, prodhuesi i kontraktuar, nëpërmjet SHPZP-së, paraqet në ministri një raport vjetor për sasinë e produkteve PZP të hedhura në tregun vendas, përfshirë të dhënat për sasi të kthyera të mbetjeve, si dhe për çdo lloj e kategori të tyre, për një vit të caktuar, si dhe të dhënat për dorëzimin e tyre ricikluesve ose trajtuesve të licencuar, brenda datës 30 prill të vitit pasardhës financiar.
 5. Rregullat për mbajtjen, paraqitjen dhe formatin e vetëdeklarimit të subjektit prodhues dhe raportit vjetor të SHPZP-së për subjektin prodhues të kontraktuar, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.
 6. Subjekti prodhues kontribuon për përmbushjen e objektivave kombëtarë për mbetjet e gjeneruara nga produktet që ka vendosur për herë të parë në treg, në masën e përcaktuar në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe në Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
 7. Duke filluar nga data 1 janar 2026, minimumi i objektivave kombëtarë, që duhen përmbushur për vitin ekzistues, është i barabartë me pjesën që ka prodhuesi në sasi totale të produkteve PZP të vendosura në treg në vitin paraardhës, të cilat i përkasin të njëjtës kategori mbetjesh për të cilën është subjekt i PZP-ve.

Neni 6

Sistemi PZP

1. Subjekti prodhues që vendos për herë të parë në treg produkte PZP, objekt i këtij ligji, krijon sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese.
2. Përveç detyrimeve të parashikuara në nenin 5, të këtij ligji, subjekti prodhues siguron:
 - a) grumbullimin e mbetjeve, që dalin nga këto produkte si mbetje bashkiake;
 - b) trajtimin e mbetjeve të grumbulluara nga produktet e përmendura në pikën 1, të këtij neni;
 - c) përmbushjen e objektivave të grumbullimit të veçantë, përgatitjes për ripërdorim, riciklimit ose procedurave të tjera të rikuperimit të mbetjeve, që dalin nga produktet sipas pikës 1, të këtij neni;
 - ç) përmbushjen e objektivave kombëtarë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Minimumi i objektivave kombëtarë, që duhen përmbushur për vitin ekzistues, është i barabartë me pjesën që ka subjekti prodhues në sasinë totale të produkteve PZP të vendosura në treg në vitin paraardhës, sipas rrymave përkatëse të mbetjeve.
3. Subjektet prodhuese zbatojnë detyrimet e tij sipas mënyrave të mëposhtme:
 - a) Organizojnë vetë sistemin e marrjes mbrapsht të grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve;
 - b) Së bashku me subjektet prodhuese të tjera organizojnë një sistem kolektiv të organizuar të marrjes mbrapsht, grumbullimit e përpunimit të mbetjeve nëpërmjet një kompanie të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie; ose
 - c) Krijojnë SHPZP për marrjen mbrapsht, grumbullimin e përpunimin e mbetjeve, në përputhje me këtë ligj.
4. Subjektet prodhuese, të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij neni, përgjigjen financiarisht dhe organizativisht për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë pikë sipas pjesës takuese përkatëse, të përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet tyre, si dhe me kompaninë e licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
5. Subjektet prodhuese, të parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 3, të këtij neni, përgjigjen financiarisht e nga ana organizative për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë pikë, sipas pjesës takuese përkatëse, të përcaktuar në kontratat e lidhura ndërmjet tyre dhe parashikimeve të këtij ligji.
6. Kontributi financiar, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, përfshin:
 - a) kthimin e të gjitha produkteve të përdorura dhe të mbetjeve të gjeneruara prej tyre;

- b) grumbullimin e diferencuar, magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të paktën për sasinë minimale të objektivit të grumbullimit të përcaktuar, sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - c) transportin, rikuperimin, ripërdorimin ose riciklimin e rrymave specifike të mbetjeve, të paktën për sasinë minimale të objektivit të trajtimit të përcaktuar, sipas parashikimeve të nenit 10, të këtij ligji;
 - ç) zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme të informimit, ndërgjegjësimit, udhëzimit ose trajnimit për t'u ofruar qytetarëve informacion për ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
 - d) investimet në infrastrukturën e grumbullimit, me qëllim që të përballojë përzgjedhjen e çdo lloj produkti PZP dhe/ose rrymat specifike të mbetjeve ose kategorinë për të cilin prodhuesi ka detyrime, që lindin nga sistemi i PZP-së;
 - dh) kostot administrative për përmbushjen e detyrimeve të vendosura në zbatim të këtij neni.
7. Kontributi financiar i përcaktuar në pikën 5, të këtij neni, nuk tejkalon kostot e kërkuara për ofrimin e shërbimeve në këtë pikë.

Neni 7

Detyrimi për informim

1. Subjekti prodhues, vetë apo nëpërmjet SHPZP-së, informon konsumatorët për:
 - a) mënyrat e ripërdorimit të produktit si të plotë ose për pjesët përbërëse të tij, mënyrat e çmontimit të produktit, si dhe të trajtimit të mbetjeve të gjeneruara pas përdorimit;
 - b) dorëzimin e produkteve që gjenerojnë mbetje në pika të afërta grumbullimi lehtësisht të aksesueshme prej tyre e të sugjeruara nga prodhuesi;
 - c) sistemet e ngritura për marrjen mbrapsht dhe grumbullimin e mbetjeve deri në asgjësim;
 - ç) vendin më të afërt për të dorëzuar mbetjet, në rast refuzimi për të kthyer mbetjet;
 - d) ndikimin që kanë mbetjet e gjeneruara në mjedis dhe shëndetin e njeriut.
2. Informacioni jepet në mënyrë të qartë në etiketën e produktit ose/dhe në faqen zyrtare të SHPZP-së.
3. Subjekti prodhues, vetë apo nëpërmjet SHPZP-së, informon tregtarët për mënyrën e kthimit të produkteve të përdorura ose të mbetjeve të krijuara nga konsumatorët, duke përfshirë edhe tregtarin e fundit, që shet dhe/ose i dorëzon produktet konsumatorit.

Neni 8

Detyrimi për regjistrim dhe kontrata me SHPZP

1. Çdo subjekt prodhues, në cilësinë e zotëruesit të rrymës specifike të mbetjeve, në rast se nuk e organizon vetë sistemin e marrjes mbrapsht, të grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve, regjistrohet në SHPZP sipas rrymës përkatëse, për të cilën është subjekt i detyrimeve të PZP-së.
2. Subjekti prodhues, subjekt i PZP-së, nënshkruan një kontratë me SHPZP-në për përmbushjen e detyrimeve lidhur me PZP-në, sipas parashikimeve të shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji, për të paktën një vit fiskal.
3. Subjekti prodhuesi lidh kontratë të veçantë vetëm me një SHPZP për çdo rrymë mbetjeje të caktuar dhe në kontratë, përveç të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet palëve, parashikohen shprehimisht rastet kur SHPZP-ja nuk arrin të përmbushë detyrimet e subjektit prodhues për PZP-në dhe objektivat e lidhur me to, si dhe/ose është në pamundësi financiare për të paguar penalitetet për mospërmbushjen e detyrimeve. Në çdo rast, detyrimet paguhen në përputhje me përqindjen e produkteve të vendosura në tregun vendas, për vitin në të cilin objektivi nuk është përmbushur.

Neni 9

Detyrimi për raportim pranë SHPZP-së

1. Subjekti prodhues i paraqet SHPZP-së një raport tremujor për sasinë e produkteve PZP të vendosura në treg brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit pasardhës. Ky afat zbatohet edhe në rastin kur prodhuesi nuk ka hedhur në treg asnjë produkt për atë periudhë trimujore.
2. Raportet trimujore për sasinë totale të produkteve të vendosura në treg gjatë një tremujori nga të gjitha subjektet prodhuese të kontraktuara nga SHPZP-ja i dërgohen AKM-së nga SHPZP-ja jo më vonë se dita e fundit e muajit pasardhës të atij tremujori.

KREU III

PËRGJEGJËSITË E SHPZP-së

Neni 10

Detyrimet e SHPZP-së

1. SHPZP-ja merr përsipër detyrimet PZP të prodhuesve, që përfaqësojnë të paktën 25 (njëzet e pesë) për qind dhe jo më shumë se 70 (shtatëdhjetë) për qind të sasive së produkteve PZP të hedhura në treg për çdo vit të ushtrimit të veprimtarisë. Pjesa e tregut llogaritet në bazë të sasisë totale të produkteve PZP për një rrymë të dhënë mbetjesh të vendosura në treg në vitin paraardhës nga të gjitha subjektet prodhuese të regjistruara.

2. SHPZP-ja ka detyrimin të pajiset me autorizim, në zbatim të nenit 11, të këtij ligji, për ushtrimin e veprimtarisë së saj.
3. SHPZP-ja nënshkruan një kontratë me subjektin prodhues, që përcakton detyrimet kryesore që përmbush secila palë, sipas kërkesave të këtij ligji dhe përmban parashikime për sasi të planifikuara për çdo rrymë e çdo lloj mbetjesh.
4. SHPZP-ja nënshkruan kontrata me grumbullues e trajtues të licencuar sipas përcaktimeve të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.
5. SHPZP-ja njofton subjektet prodhuese të kontraktuara për veprimtaritë lidhur me mbledhjen e trajtimin e mbetjeve gjatë vitit paraardhës, duke specifikuar përmbushjen e objektivave minimalë dhe pjesën e tregut, brenda datës 30 prill të vitit pasardhës.
6. SHPZP-ja mbledh e raporton të dhëna në ministri, sipas parashikimeve të këtij ligji, nëpërmjet të cilave vërtetohet qartë se detyrimet PZP janë përmbushur për secilin subjekt prodhues dhe për rrymat e veçanta të mbetjeve.

Neni 11 **Autorizimi i SHPZP-së**

1. Për pajisjen me autorizim, SHPZP-ja plotëson kriteret e mëposhtme:
 - a) Regjistrohet pranë QKB-së si shoqëri tregtare, me objekt veprimtarie menaxhimin e mbetjeve dhe përgjegjësitë e zgjeruara të subjektit prodhues;
 - b) Vërteton dakordësinë e përfaqësimit të subjekteve prodhuese, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, për secilën rrymë mbetjesh, objekt i këtij ligji;
 - c) Pagues kontributin financiar për pajisjen me autorizim.
2. SHPZP-ja, para fillimit të çdo aktiviteti për përmbushjen e detyrimeve PZP, aplikon në portalin unik qeveritar “e-Albania” për pajisjen me autorizim vetëm për një rrymë mbetjesh, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
3. SHPZP-ja pajiset me autorizim nga ministria përgjegjëse për mjedisin, sipas modelit të miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, për ushtrimin e veprimtarisë për një rrymë specifike, në përputhje me parimet e procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.
4. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 5- (pesë-) vjeçare.

5. Në rast mospërmbushjesh të detyrimeve të SHPZP-së ndaj subjekteve prodhuese, SHPZP-së i pezullohet ose i anulohet autorizimi përkatës, sipas parashikimeve të këtij ligji.
6. Dokumentacioni për pajisjen me autorizim, procedurat e shqyrtimit të aplikimit, afatet dhe kontributi financiar për pajisjen me autorizim për SHPZP-në miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 12

Zgjidhja e kontratës së SHPZP-së me subjektin prodhues

1. Në rast se SHPZP-ja nuk përmbush objektivat minimalë për mbledhjen e trajtimin e një rryme specifike mbetjeje me më shumë se 10 (dhjetë) për qind, SHPZP-ja paguan një gjobë të barabartë me dyfishin e vlerës së kontributit financiar përkatës.
2. SHPZP-ja zgjidh kontratën me subjektin prodhues, në rast se ky i fundit nuk paguan kontributin financiar përkatës të autorizimit për dy periudha të njëpasnjëshme pagesash.
3. SHPZP-ja, e cila zgjidh kontratën sipas pikës 1, të këtij neni, shkarkohet nga detyrimi për mbledhjen e trajtimin e mbetjeve në përpjesëtim me sasinë për të cilën prodhuesi nuk ka paguar kontributin financiar takues.
4. Nëse subjekti prodhues e ka paguar kontributin financiar takues të SHPZP-ja, së cilës i hiqet autorizimi, ky subjekt prodhues nuk paguan detyrime të tjera për këtë pjesë të vitit për të cilin ka paguar.
5. AKM-ja njofton strukturat inspektuese për mospërmbushjen e objektivave nga SHPZP-ja dhe prodhuesit e kontraktuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e konstatimit të mospërmbushjes së tyre. Struktura inspektuese merr masa për vendosjen e gjobës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit.

Neni 13

Kontributi financiar për SHPZP-në

1. SHPZP-ja njofton me shkrim ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe AKM-në për përmbushjen e detyrimeve financiare nga ana e subjekteve prodhuese për çdo rrymë dhe lloj mbetjeje, si dhe kushtet e përgjithshme të kontratës me secilin prej tyre brenda datës 15 nëntor të çdo viti, duke nisur nga viti i themelimit të SHPZP-së.
2. Subjekti prodhues i paguan SHPZP-së kontributin financiar çdo tre muaj, sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet tyre, për sasinë e produkteve dhe të rrymave specifike të mbetjeve, në përputhje me nenin 15, të këtij ligji.

3. Kontributi financiar, që subjekti prodhues ka detyrimin t'i paguajë SHPZP-së, nuk duhet të jetë më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind e kontributit financiar për atë produkt, subjekt i PZP-së.
4. SHPZP-ja bën publike të dhënat për kontributin financiar të autorizimit dhe kontratat e nënshkruara me subjektin prodhues, lehtësisht të aksesueshme dhe të dukshme.
5. Kontributi financiar i paguar nga subjekti prodhues të SHPZP-ja mbulon kostot për përmbushjen e detyrimeve të tyre PZP, si më poshtë vijon:
 - a) Kostot për grumbullimin dhe trajtimin për çdo lloj mbetjeje, përfshirë kostot e eliminimit të tepricave të mbetjeje, nëse ka;
 - b) Kostot operative për veprimtarinë e SHPZP-së;
 - c) Kostot për komunikimin me publikun dhe aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit;
 - ç) Kostot për investimet në infrastrukturën e mbledhjes së mbetjeje në mënyrë që të mundësohet përzgjedhja e rrymave specifike dhe llojeve të mbetjeje, për të cilat është autorizuar SHPZP-ja.

Neni 14

Detyrimi për informim i SHPZP-së

1. SHPZP-ja shpenzon një shumë në masën nga 10 (dhjetë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) për qind të të ardhurave totale të vitit paraardhës për aktivitete nxitëse dhe promovuese, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorët për zbatimin e këtij ligji dhe për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeje, si dhe ndarjen në burim e trajtimin e tyre.
2. Përjashtimisht për 3 (tri) vitet e para të autorizimit, SHPZP-ja shpenzon deri në 20 (njëzet) për qind të të ardhurave totale të vitit paraardhës për aktivitetet e përmendura në pikën 1, të këtij neni.
3. SHPZP-ja bashkëpunon me SHPZP të tjera, subjektet prodhuese, tregtarë, persona të tjerë juridikë, institucione shtetërore e private, si dhe me ministrinë për të zhvilluar aktivitete të përshtatshme informacioni, ndërgjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë.

Neni 15

Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. SHPZP-ja bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe financojnë së bashku infrastrukturën për grumbullimin e diferencuar të mbetjeje, ku përdoruesit e fundit dorëzojnë mbetjet pa pagesë, pa rënë ndesh me

parashikimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe për vetëqeverisjen vendore.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me SHPZP-në, në mënyrë që kjo e fundit të ofrojë shërbimet e veta në territorin, që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore, dhe të organizojë e të zbatojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.
3. SHPZP-ja dhe njësia e vetëqeverisjes vendore lidhin një kontratë me shkrim për mënyrën e bashkëpunimit, në të cilën mund të përcaktohet që ngritja dhe funksionimi i skemës së PZP-së të kryhet vetëm nga SHPZP-ja për atë rrymë mbetjesh që ka autorizim apo vetëm nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose të dyja së bashku.
4. Kontrata që lidhet sipas pikës 3, të këtij neni, mbulon detyrimet kryesore të secilës palë, sipas kërkesave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij. Kontrata përmban të paktën elementet e mëposhtme:
 - a) Kërkesat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, duke përfshirë rrymën specifike të mbetjeve, numrin e popullsisë për zonën ku ofrohet shërbimi, vendndodhjen e mbetjeve, si dhe periodicitetin e ofrimit të shërbimit;
 - b) Objektivat për grumbullimin e diferencuar, riciklimin dhe rikuperimet e tjera të mbetjeve, si dhe mënyrën e raportimit për përmbushjen e këtyre objektivave;
 - c) Kushtet dhe afatet për monitorimin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji, në territorin që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore;
 - ç) Kushtet për zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme: informacioni, ndërgjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në territorin që ka nën juridiksion njësia e vetëqeverisjes vendore;
 - d) Kushtet për bashkëfinancimin e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

KREU IV INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Neni 16 Institucionet përgjegjëse

1. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:
 - a) ministria përgjegjëse për mjedisin;
 - b) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
 - b) struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit;
 - c) struktura përgjegjëse për inspektimin për mbikëqyrjen e tregut;
 - ç) institucioni përgjegjës për doganat;
 - d) institucioni përgjegjës për tatimet;

- dh) njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Institucionet përgjegjëse ushtrojnë detyrat sipas legjislacionit përkatës dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre.

Neni 17 **Ministria përgjegjëse për mjedisin**

Ministria është institucioni përgjegjës për:

- a) mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- b) koordinimin ndërinstitucional lidhur me zbatimin e mirëfunksionimit të sistemit PZP;
- c) pajisjen me autorizim për SHPZP-në, për ushtrimin e veprimtarive lidhur me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të krijuara nga produktet dhe rrymave specifike të mbetjeve për rikuperimin, ripërdorimin ose riciklimin e tyre;
- ç) përgatitjen dhe propozimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji;
- d) informimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për zbatimin e sistemit PZP, kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit.

Neni 18 **Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin**

Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e sistemit të përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese janë:

- 1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim, AKM), si institucioni përgjegjës i kontrollit në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhur me produktet PZP për:
 - a) krijimin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit të produkteve PZP për prodhuesit PZP dhe SHPZP, sipas përcaktimeve të nenit 28, të këtij ligji;
 - b) verifikimin e të dhënave dhe kontrollin e tregtarit, të subjekteve prodhuese PZP dhe SHPZP në lidhje me informacionin e përfshirë në raportimet përkatëse pranë Agjencisë, sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - c) monitorimin e strukturave dhe hapësirave, ku prodhohen, ruhen, përdoren ose shiten produktet PZP;
 - ç) kryerjen e kontrollit të tërheqjes së produkteve, në rast se nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji;
 - d) kur i kërkohet, asistimin e institucioneve përgjegjëse për identifikimin e produkteve PZP.
- 2. struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, e cila inspekton subjektet prodhuese për zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe vendosjen e masave administrative përkatëse;

3. struktura përgjegjëse për inspektimin për mbikëqyrjen e tregut, që kryen këto veprime:
 - a) Ushtron kontrolle të përshtatshme për karakteristikat e produkteve PZP, përfshirë dhe pikat e shitjes së produkteve PZP, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;
 - b) organizon, në bashkëpunim me operatorët ekonomikë, kthimin/tërheqjen nga tregu të produkteve PZP, në rast se nuk plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - c) Siguron marrjen e masave për ndalimin e tregtimit ose ndalimin apo kufizimin e bërjes së disponueshme të produkteve PZP në treg, kur nuk plotësojnë kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm.
4. Autoriteti doganor është përgjegjës për kontrollin e produkteve, pjesë e sistemit të PZP-së në pikat doganore të hyrjes e të daljes.
5. Kontrollat e përcaktuara në këtë nen kryhen sipas parimeve, procedurave dhe në mënyrën e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për inspektimin, legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, atë doganor dhe atë për mbikëqyrjen e tregut.

KREU V

REGJISTRIMI DHE RAPORTIMI

Neni 19

Regjistri i produkteve të prodhuesve PZP dhe SHPZP

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron bazën e të dhënave shtetërore të Sistemit të Informacionit të Integruar Mjedisor, pjesë e të cilave janë edhe të dhënat për subjektet prodhuese për çdo produkt PZP dhe të SHPZP-ve.
2. Subjektet prodhuese PZP dhe SHPZP raportojnë pranë Agjencisë çdo ndryshim të të dhënave.
3. Struktura përgjegjëse në AKM verifikon të paktën çdo 5 (pesë) vjet të dhënat e prodhuesve PZP dhe SHPZP.
4. AKM-ja publikon e përditëson çdo vit regjistrin me të dhënat për sasinë totale të produkteve PZP, sipas llojit dhe rrymave të mbetjeve të krijuara.
5. Rregullat e detajuara në zbatim të pikës 1, të këtij neni, të dhënat parësore dhe dytësore, si dhe niveli i aksesueshmërisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 20

Procedura për regjistrimin e subjekteve prodhuese

1. Subjekti prodhues aplikon për regjistrim në portalin unik qeveritar “e-Albania” dhe pajiset nga AKM-ja me certifikatën e regjistrimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve punë nga dita e aplikimit.
2. Rregullat për procedurën e regjistrimit dhe të çregjistrimit, afatet, dokumentacioni, mbajtja e të dhënave dhe përditësimi i tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 21

Raportimi vjetor

1. Subjektet prodhuese PZP dhe SHPZP raportojnë në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe AKM çdo 6 (gjashtë) muaj, në dy vitet e para të regjistrimit dhe të autorizimit të tij e, pas këtij afati, raportimi bëhet një herë në vit, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij neni.
2. Subjektet prodhuese PZP dhe SHPZP paraqesin, brenda datës 30 prill të çdo viti, në strukturën përgjegjëse për mbetjet në ministri dhe në AKM raportin vjetor për produktet PZP të hedhura në treg, të audituara nga audituesi i licencuar.
3. Raporti përmban të dhëna për sasinë totale të produkteve PZP të vendosura në treg, sasitë e mbledhura dhe të trajtuara sipas produktit PZP dhe rrymave specifike të mbetjeve, si dhe përmbushjen e objektivave kombëtarë të mbetjeve.
4. Formatit dhe mënyra e përgatitjes dhe e dorëzimit të raportit vjetor përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.
5. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe AKM-ja marrin masat e nevojshme për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të dorëzuar sipas këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, MASAT DHE EKZEKUTIMI

Neni 22

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë sipas kufijve dhe përcaktimeve në pikën 2, të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin.

2. Dënohen me gjobë shkeljet e mëposhtme:

- a) Mospërmbushja e detyrimit për regjistrim në regjistrin që administron AKM-ja, mosmbajtja e regjistrit dhe raportimi për sasinë e produkteve të prodhuara ose të importuara, sipas parashikimeve të shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji, nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë;
 - b) Mospërmbushja e detyrimit të subjektit prodhues të produkteve PZP lidhur me pagesën e kontributit financiar të sistemit PZP, sipas parashikimeve të shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;
 - c) Mospërmbushja e detyrimeve për informimin e konsumatorëve nga subjekti prodhues, sipas parashikimeve të shkronjës “e”, të pikës 2, të nenit 5, dhe të nenit 7, të këtij ligji, nga 100 000 deri në 200 000 lekë;
 - ç) Mosparaqitja e vetëdeklarimit për vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji, nga 100 000 lekë deri në 200 000 lekë;
 - d) Mospërmbushja e detyrimit nga subjekti prodhues, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;
 - dh) Mospajisja me autorizim e SHPZP-së, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;
 - e) Mospërmbushja e detyrimit për raportimin periodik dhe vjetor nga ana e subjekteve prodhuese PZP dhe SHPZP, dënohet me gjobë, përkatësisht, 200 000 lekë për subjektin prodhues dhe 500 000 lekë për SHPZP-në;
 - ë) Mospërmbushja e detyrimit nga SHPZP-në, në përputhje me pikën 1, të nenit 12, të këtij ligji, nga 200 000 lekë deri në 500 000 lekë;
 - f) Dhënia e informacionit të pasaktë nga ana e subjektit prodhues PZP dhe SHPZP, nga 100 000 deri në 200 000 lekë;
 - g) Hedhja në treg dhe tregtimi i produkteve, që nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji, nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;
 - gj) Mospërmbushja e detyrimeve për informimin e konsumatorëve nga SHPZP-ja, sipas parashikimeve të nenit 14, të këtij ligji, nga 200 000 deri në 300 000 lekë;
 - h) Mospajisja me certifikatë regjistrimi e subjektit prodhues, sipas parashikimeve të nenit 20, të këtij ligji, nga 50 000 deri në 100 000 lekë;
 - i) Mospërmbushja e objektivave të minimumit të objektivave kombëtarë nga SHPZP-ja për mbledhjen dhe trajtimin e një rryme specifike mbetjeje me më shumë se 10 (dhjetë) për qind, të barabartë me dyfishin e vlerës së kontributit financiar.
3. Gjopa e dhënë në zbatim të këtij neni, pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, përbën titull ekzekutiv. Gjopa e njoftuar nga organi përgjegjës paguhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data kur ajo është kthyer në titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbarimit, sipas rregullave

të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.

4. Të ardhurat e mbledhura nga gjobat derdhen 100 (njëqind) për qind në buxhetin e shtetit.

Neni 23

Procedura e kundërvajtjeve administrative

1. Kontrolli i zbatimit të këtij ligji dhe i akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe vendosja e gjobës dhe/apo pezullimi ose ndërprerja e veprimtarisë, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin, kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit dhe struktura përgjegjëse inspektuese për mbikëqyrjen e tregut, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.
2. Konstatimi i kundërvajtjeve administrative të parashikuara në nenin 22, të këtij ligji, dhe vendosja e gjobës bëhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin në mjedis dhe struktura përgjegjëse inspektuese për mbikëqyrjen e tregut, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.
3. Kundër vendimit të masës administrative të vendosur nga struktura përgjegjëse inspektuese për mbikëqyrjen e tregut bëhet ankim, në përputhje me legjislacionin e posaçëm të zbatueshëm për inspektimin e mbikëqyrjes së tregut.
4. Kundër vendimit të masës administrative të vendosur nga struktura përgjegjëse për inspektimin në mjedis bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin dhe shqyrtimi e marrja e vendimit përfundimtar, ekzekutimi dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, si dhe me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

Neni 24

Pezullimi dhe anulimi i autorizimit

1. Pavarësisht nga dënimet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të pikës 2, të nenit 30, të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i propozon ministrit përgjegjës për mjedisin:
 - a) pezullimin e autorizimit për SHPZP-në, në rastet kur:
 - i. paraqitet kërkesë nga SHPZP-ja;
 - ii. SHPZP-ja nuk përmbush kushtet e parashikuara në autorizim dhe në kërkesat e këtij ligji;
 - b) anulimin e autorizimit të SHPZP-së, në rastet kur:
 - i. paraqitet kërkesë nga SHPZP-ja;

- ii. SHPZP-ja ka shkelur në mënyrë të përsëritur dispozitat e këtij ligji, gjë që ka çuar në vënien e gjobave administrative, në përputhje me nenin 30, të këtij ligji;
 - iii. SHPZP-ja nuk ka zbatuar brenda afatit të pezullimit detyrimet e përcaktuara si shkaqe të pezullimit;
 - iv. SHPZP-ja nuk ka paguar gjobat administrative të vëna sipas këtij ligji.
2. Ministri përgjegjës për mjedisin nxjerr urdhrin e pezullimit të autorizimit, duke i lënë subjektit një afat prej 20 (njëzet) ditësh për ripërbushjen e shkaqeve të pezullimit.
 3. Subjekti, ndaj të cilit vendoset urdhri i pezullimit, ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.
 4. Në rast se subjekti plotëson detyrimet për shkaqet e pezullimit, ministri shfuqizon urdhrin e pezullimit.
 5. Në rast se subjekti nuk përmbush brenda afatit të pezullimit detyrimet e përcaktuara në shkaqet e pezullimit, ministri nxjerr urdhrin e anulimit të autorizimit përkatës.
 6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit publikon aktin e pezullimit apo të anulimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.
 7. SHPZP-ja, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit administrativ, sipas afateve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi.
 8. Kundër vendimit të ministrit, SHPZP-ja ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 (dy) vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 6, 19, pika 5, dhe 20, pika 2, të tij.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin që, brenda 2 (dy) vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 5, dhe 21, pika 4, të tij.

Neni 26
Dispozita kalimtare

1. Subjektet prodhuese, të cilat, në bazë të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, kanë detyrimin e pagesës së taksës për materiale/artikuj plastike dhe të taksës së ambalazheve prej plastike/qelqi, përjashtohen nga detyrimi i pagesës së kontributit financiar, sipas këtij ligji.
2. Kërkesat dhe procedurat administrative për shërbimet që preken nga ky ligj zbatohen në momentin që përfundojnë zhvillimet teknike për pritjen e aplikimeve në Sistemin e Informacionit të Integruar Mjedisor.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet më 1 qershor 2026.

K R Y E T A R I

ELISA SPIROPALI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

P Ë R

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR PËRGJEGJËSITË
E ZGJERUARA TË SUBJEKTEVE PRODHUESE TË PRODUKTEVE
QË GJENEROJNË MBETJE”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I TURIZMIT
DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI